



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Komisioni për Arsim, Shkencë,
Teknologji, Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja e datës 24.09.2007
Salla nr. N.225 ora 11,00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Enver Hoxhaj, Nimon Alimusaj, Mark Krasniqi, Remzije Nimani, Drita Statovci, Sala Ahmetaj, Gjylshene Berisha, Genc Gorani, Naxhije Doçi, Myrvete Dreshaj dhe Ramë Buja.
Munguan: Ragip Zekolli, Nuran Malta dhe Gojko Saviq.

Nga sekretaria e Kuvendit mori pjesë Lule Ymeri.

Mbledhjen e udhëhoqi, Enver Hoxhaj, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
2. Hartimi i rekomandimeve për rininë;
3. Shqyrtimi i Projekt ligjit për arsimin dhe aftësimin privat

Rendi i ditës u miratua nga të pranishmit.

1. Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

2. Kryetari i Komisionit Enver Hoxhaj, filloi me shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës, ku i njoftoi anëtarët e Komisionit me takimin e tij me kryetarin e Kuvendit lidhur me përshpejtimin e punës për projektligjet të cilat aktualisht gjenden në procedurë, në këtë rast lidhur me projektligjit për arsimin dhe aftësimin privat.

Lidhur me këtë projektligj, ai kërkoi nga anëtarët e Komisionit të merret ndonjë qëndrim konkret me mënyrën e qasjes ndaj këtij projektligji, për të cilin Komisioni ka mbajtur disa takime dhe dy dëgjime publike ku janë ftuar përfaqësues të ndryshëm të institucioneve të arsimit publik dhe privat, dhe nga këto dëgjime Komisioni nuk ka arritur të marrë ndonjë rekomandim apo sugjerim konkret që do të mundësonte përmirësimin apo rregullimin e kësaj çështjeje.

Lidhur me këtë projektligj, Komisioni ka kërkuar edhe angazhimin e një eksperti ndërkombëtar që do të ndihmonte në shqyrtimin apo amendamentimin e tij, mirëpo nga OSBE-ja ende nuk ka arritur ndonjë sugjerim konkret për ekspertë të cilët do të ndihmonin në përmirësimin apo amendamentimin e të njejtit. Lidhur me këtë diskutuan anëtarët e Komisionit.

Myrvete Dreshaj, tha se ne si Komision duhet të vlerësojmë vlershmërinë apo mos vlershmërinë e këtij projektligji, të shohim sa është e nevojshme që ne të kemi një ligj të tillë, në mënyrë që të zgjidhet dilema a të fillojmë me propozime apo ti'a kthejmë të njejtin projektligj Qeverisë.

Sala Ahmetaj, tha se me këtë çështje jemi marrë shumë gjatë dhe mendon se me amendamentimin e Ligjit për Arsimin Fillor dhe të Mesëm, të Ligjit për Arsimin e Lartë, si dhe me miratimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve do të rregullohej edhe çështja e arsimit privat.

Ajo tha se në parim nuk është kundër universiteteve private por është për kritere unike të vlerësimit, që do të duhej të ishin të njejtë si për institucionet e arsimit privat ashtu edhe për institucionet e arsimit publik dhe si të tilla duhet rregulluar me Ligjet e arsimit.

Mark Krasniqi ishte skeptik sa i përket fushës së arsimit privat, dhe se shkollat private dhe personeli mësimor në këto shkolla duhet të kenë një mbikqyrje rigoroze me qëllim të mbarëvajtjes së tyre.

Nimon Alimusaj mendon se nevoja për një ligj i cili do të rregullonte këtë çështje është e madhe, këtë e kemi vërtetë me vizitat që ne si Komision i kemi bërë Institucioneve private të arsimit. Me Ligj duhet rregulluar edhe shumë çështje që janë paraparë si p.sh. kushtet e pranimit të studentëve, kur dihet se në institucionet private të arsimit studentët pranohen me lehtësi dhe se nota mesatare e tyre është e kënaqshme, pastaj kontrollimi i cilësisë, suksesi i nxënësve dhe shumë çështje tjera duhet rregulluar me Ligj.

Nagji Doçi the se pasi që shkollat private janë evidente dhe numri i tyre po rritet vazhdimisht, është e nevojshme të vendoset rregullativa ligjore edhe në sferën e arsimit privat me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve tanë.

Drita Statovci tha se pavarësisht nga lloji i institucionit të arsimit duhet të kemi vlera unike, kualiteti i institucioneve duhet të përcaktohet nga kriteret e tij dhe për këtë çështje duhet të merremi ne si Komision.

Ramë Buja në diskutimin e tij u përqëndrua në kohën e shkurtër pasi që zgjedhjet po afrohen , ai tha se lidhur me shqyrtimin e këtij projektligji do të duhej një kohë e gjatë dhe për këtë do të na ndihmonte shumë përvoja e Irlandës.

Myrvete Dreshaj kishte një propozim që Projektligjit t'i ndrryshohet titulli pasi që projektligji më tepër merret me çështjen e licencimit të institucioneve të arsimit .

Gjylshene Berisha ishte skeptike se për një kohë të shkurtër prej një muaji do të mund të bënim diq që të amendamentohet ky projektligj dhe si Komision, kërkoi që edhe një herë të kërkojmë nga përfaqësuesit e OPSBE-së ekspert.

Remzije Nimani ishte e mendimit se me sigurimin e ekspertit do të fillojmë dhe do ti qasemi me përkushtim amendamentimit të këtij projektligji.

Enver Hoxhaj në vazhdim tha se me fillimin e punës së Agjencionit për Akreditim të Kosovës, i cili ka për detyrë vlerësimin e cilësisë së programeve të arsimit të lartë nga do të bëhet një ndihmë e madhe në ngritjen e cilësisë së arsimit të lartë në vend edhe në këtë segment.

Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit me kërkesën e tyre u vendos që nëse deri të hënën e ardhshme nuk sigurohet eksperti, atëherë projektligji t'i kthehet Qeverisë.

3. Hartimi i rekomandimeve për rininë;

Me kërkesën e kryetarit të Komisionit, kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për mbledhjen e ardhshme me qëllim të përgatitjes së rekomandimeve.

Komisioni përfundoi mbledhjen në orën 12,10

Kryetari i Komisionit,
Enver Hoxhaj